



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV

Kryesia e Kuvendit

P-075

Prishtinë, më 11 shtator 2012, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 11 SHTATOR 2012

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, kryetar i Kuvendit, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Enis Kervan dhe Petar Miletiq, nënkryetarë të Kuvendit.

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Ismet Beqiri, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani dhe Albert Kinolli.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i kryetarit të Kuvendit: Bilall Sherifi, Eshref Vishi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Daut Beqiri, Sali Rexhepi dhe Sherif Konjufca;

Nga Presidenca: Amir Haradinaj dhe

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit të ditës.

Kryesia i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 3 shtator 2012,
2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës,
3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave.

* * *

1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 shtator 2012

Procesverbali i mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 3 shtator 2012, u miratua pa vërejtje.

2. Përgatitjet për seancën plenare të radhës

Kryesia, pasi i shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare vendosi që Kuvendi gjatë kësaj jave t'i mbajë dy seanca plenare.

Seanca plenare, më 13 shtator 2012, do t'i zhvillojë punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i procesverbalit të seancës së mëparshme,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për procedurën përmbartimore,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për Agjencinë për menaxhimin e komplekseve memoriale të Kosovës,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ujërat e Kosovës,
7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për procedurën kontestimore,
8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për bujqësinë organike,
9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Seanca plenare, më 17 shtator 2012, do t'i zhvillojë punimet me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Debat parlamentar lidhur me procesin e privatizimit në Kosovë,
4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Avokatit të Popullit për vitin 2011,
5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për vitin 2011
6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të performancës me pasqyrat e audituara financiare të Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm për vitin 2011.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe i kërkesave:

3.1 Njoftimi i Grupit Parlamentar “6+” për ndërrimin e kryetarit të këtij grupi

Kryetari i njoftoi të pranishmit se Grupi Parlamentar “6+”e ka njoftuar Kryesinë e Kuvendit për ndërrimin e kryetarit të këtij grupi, sipas marrëveshjes ndërmjet subjekteve politike: VAKAT, PREBK dhe KDTP.

Kështu, në vend të deputetit Albert Kinolli, prej datës 1 shtator 2012, kryatare e Grupit Parlamentar “6+” do të jetë deputetja Myfera Shinik.

Kryetari e falënderoi kryetarin e deritanishëm të këtij grupi, z. Albert Kinolli për kontributin e dhënë.

3.2. Shënimi i Ditës Ndërkombëtare të Demokracisë

Sekretari i Kuvendit, Ismet Krasniqi, e informoi në hollësi Kryesinë e Kuvendit për përgatitjet që kishte bërë Administrata e Kuvendit, në bashkëpunim me Institutin Kombëtar Demokratik, për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të Demokracisë në hapësirat e Kuvendit.

Financimin e këtij aktiviteti parashihet ta mbulojë NDI-ja me 60%, apo 5 796,00€, ndërsa Kuvendi i Kosovës, me 40%, apo 3 864,00€.

Kryesia e miratoi propozimin e sekretarit të Kuvendit për ta shënuar Ditën Ndërkombëtare të Demokracisë, si dhe për ta mbuluar pjesën e shpenzimeve lidhur me aktivitetet e sipërshënuara.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 11:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi: Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale